


 REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0 /DPK
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Nr. I faq.	Prot No.
Broj stranica	Data
Nr. pages	Datum
	Date
PRISHTINE	

01-582/14
14.02.2014



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 pika 11,12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.02.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mylllet rasti me nr. AKK-03-4302/13, për z. Ragip Shabani – Ndihmës Drejtor për Arsim në Zyren e Drejtorit Ekzekutiv - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për Zyrtarin e lartë, z. Ragip Shabani - Ndihmës Drejtor për Arsim në Zyren e Drejtorit Ekzekutiv - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Shabani është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Shabani, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Zyrtari i lartë z. Shabani ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë(DPKI.03- 539/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte në biznesin privat N.Sh. "Biolab - R", për të ushtruar funksionin e tij publik si Ndihmës Drejtor për Arsim në Zyren e Drejtorit Ekzekutiv në Qendren Klinike Universitare të Kosovës.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

